

UDHËZIM
Nr. 8, datë 14.2.2020

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 26, DATË 4.9.2008
“PËR TAKSAT KOMBËTARE”, TË NDRYSHUAR

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 26, datë 4.9.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 2.3.1, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

“a) Fjalë e parë “Taksa vjetore e mjeteve...”, zëvendësohet me fjalinë me këtë përmbajtje:

“Taksa vjetore e mjeteve të përdorura të transportit është taksë vjetore për çdo vit kalendarik nga 1 janari deri më 31 dhjetori të vitit përkatës, për të cilën llogaritet dhe paguhet dhe ka vlefshmëri 365 ditë, pavarësisht nga momenti në të cilën ajo paguhet”.

b) Paragrafët që fillojnë me fjalinë: “Pronari i mjetit, i cili nuk kryen pagesën...” deri në fund të fjalisë “Drejtoritë rajonale të shërbimeve të transportit rrugor bëjnë regjistrimin ditor të arkëtimit të taksës.....”, zëvendësohen me paragrafët me këtë përmbajtje:

“Pronari i mjetit, i cili nuk kryen pagesën e kësaj takse brenda 10 ditëve nga mbarimi i afatit të vlefshmërisë së parashikuar, detyrohet të paguajë një gjobë prej 0.06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë vonesë nga dita e fundit e vlefshmërisë. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike”.

Shembull:

“Mjeti me cilindratë 2993 cm³, me naftë dhe vit prodhimi 2003, për vitin 2019 ka paguar taksën vjetore të mjeteve të përdorura në datën 20.5.2019, në vlerën 17,958 lekë me afat vlefshmërie deri më 19.5.2020. Më datën 20.5.2020, pronari i mjetit paguan detyrimet për taksat e vitit 2020 dhe pajiset me vërtetim/konfirmim për kryerjen e kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit”.

Shembull:

Mjeti me cilindratë 2993 cm³, me naftë dhe vit prodhimi 2003, për vitin 2019 ka paguar taksën vjetore të mjeteve të përdorura në datën 20.12.2019, në vlerën 17,958 lekë me afat vlefshmërie deri më 19.12.2020. Më datën 20.1.2020, pronari i mjetit paraqitet për kryerjen e kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit.

Duke qenë se kontrolli teknik i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre kryhet brenda periudhës së vlefshmërisë 365-ditore të taksës vjetore të mjeteve të përdorura, konkretisht mjeti është brenda afatit të vlefshmërisë që është data 20.12.2020, pronari i mjetit pajiset me vërtetim/konfirmim për kryerjen e kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Për mjetin detyrimi për taksën e vitit 2020 ka lindur nga data 1.1.2020, por pronari afatin për ta paguar taksën e këtij viti e ka deri më datën 19.12.2020.

Shembull:

Mjeti me cilindratë 2993 cm³, me naftë dhe vit prodhimi 2003, për vitin 2018 ka paguar taksën vjetore të mjeteve të përdorura në datën 22.9.2018, në vlerën 16,462 lekë me afat vlefshmërie deri më 22.9.2019. Më datën 20.1.2020, pronari i mjetit paraqitet për të paguar taksat e vitit 2019 për mjetin dhe ka lindur detyrimi i taksave edhe për vitin aktual 2020. Llogariten dhe paguhet taksat e vitit 2019 në vlerën 17,958 lekë, por duke qenë se i ka kaluar afati i vlefshmërisë prej 120 ditësh kalendarike duhet të paguajë gjobë për pagesë të vonuar në shumën 1,293 lekë (17,958 lekë x 120

ditë $\times 0.06\% = 1,293$ lekë). Në total detyrimet e TVMP-së për vitin 2019 janë në shumën 19,251 lekë.

Duke qenë se pronari i mjetit është paraqitur më datë 20.1.2020, vlefshmëria e TVMP-së për vitin në vazhdim llogaritet nga data 1.1.2020. Për këtë arsye, përveç taksës së vitit 2019, pronari i mjetit detyrohet të paguajë edhe detyrimin e TVMP-së për vitin 2020, në shumën 19,455 lekë dhe gjobë për pagesë të vonuar prej 233 lekë ($19,455 \times 20$ ditë $\times 0.06\%$). Në total vlera e taksave për vitin 2020 që duhet të paguajë është 19,688 lekë, me afat vlefshmërie deri më 20.1.2021.

Të ardhurat nga TVMP-ja, për çdo rast mbledhen nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, nëpërmjet drejtorive rajonale, dhe shpërndahen sipas procedurave të përcaktuara.

Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor bën ndarjen e të ardhurave nga TVMP-ja për secilën njësi të qeverisjes vendore, mbështetur në vendbanimin e taksapaguesit sipas regjistrimit të gjendjes civile ose adresës së ushtrimit të aktivitetit sipas adresës në QKB, sipas procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Nga shuma mujore e arkëtimeve nga TVMP-ja, drejtoritë rajonale të DPSHTRR-së, pasi mbajnë komisionin prej 5(pesë)% të totalit mujor të arkëtimeve, 25 (njëzet e pesë)% e diferencës (25% e 95% të totalit mujor të arkëtimeve nga TVMP-ja) të arkëtimeve e derdhin në llogarinë bankare të degës së thesarit të rrethit, ku është njësia e qeverisjes vendore. Pjesa tjetër e mbetur prej 75 (shtatëdhjetë e pesë) % (75% e 95% të totalit mujor të arkëtimeve nga TVMP-ja) paguhet për llogari të drejtorisë rajonale tatimore ku është e regjistruar DPSHTRR-ja (Drejtoria Rajonale Tatimore Njësia e Tatimpaguesve të Mëdhenj) brenda datës 15 të muajit pasardhës.

Rakordimi i pagesës së TVMP-së ndërmjet strukturave të DPSHTRR-së me organet tatimore të qeverisjes qendrore dhe vendore bëhet në bazë të regjistrimit ditor të taksës vjetore të mjeteve të përdorura. Llogaritja e taksës bëhet nga sistemi informatik i DPSHTRR-së, pagesa e kësaj takse shoqërohet me faturë.

Ky dokument prodhohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe shpenzimet përballohen nga ky institucion në zbatim të nenit 8, pika 3, shkronja “c”, të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar. Fatura e taksës duhet të përmbajë elemente sigurie, për të shmangur falsifikimin e saj.”.

2. Në pikën 2.8.8.1, hiqet fjala “shembuj” dhe përpara paragrafëve “a”, “b”, “c” dhe “d” shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Për përjashtimet e përcaktuara më poshtë sipas shkronjave “a”, “b”, “c” dhe “d”, procedura sipas pikave 2.8.8.2 dhe 2.8.8.3 aplikohet vetëm për lëndët e para në formë primare që klasifikohen në kodet 3901 deri në 3914 të NKM-së.”.

3. Në pikën 2.11 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

“a) Në shkronjën “b” të gjithë paragrafët që fillojnë me fjalinë “Vlera e mjetit do të plotësohet nga...” deri në fillim të pikës 2.11.1 ndryshohen në përmbajtje me paragrafët e mëposhtëm:

b) Pas shkronjës “b” shtohen shkronjat “c” dhe “d” me këtë përmbajtje:

“c. Vlera e mjetit plotësohet në sistemin informatik të DPSHTRR-së në fushën “vlera e mjetit”, kur:

- mjeti regjistrohet për herë të parë;
- ose/dhe sa herë ndryshon pronësia e tij;

- si dhe kur nga kontrolli i dokumentacionit financiar në dosjen e mjetit është konstatuar se vlera e mjetit në sistemin informatik të DPSHTRR-së nuk është vlera e duhur, referuar ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Për mjetet që kryejnë regjistrim për herë të parë në DPSHTRR, vlera e mjetit do të merret nga:

- Deklarata me referencë doganore DAV, e cila llogaritet si totali i vlerës së tatueshme (baza e tatueshme) mbi të cilën llogaritet tatimi mbi vlerën e shtuar dhe duke i shtuar TVSH-në e llogaritur në doganë (Totali = Baza e tatueshme + TVSH);

- Fatura tatimore e shitjes, e cila është vlera totale e barabartë me vlerën e tatueshme duke i shtuar dhe tatimin mbi vlerën e shtuar.

- Për rastet me kontratë të qirasë financiare (leasing), do të merret vlera totale në kontratën e qirasë financiare dhe jo vlera në kontratën e furnizimit (kontratë shitjeje), e cila i shërben qiramarrësit për njohjen faktike të pronësisë së automjetit nga qiradhënësi te qiramarrësi dhe që lidhet midis palëve vetëm pas shlyerjes prej qiramarrësit të këstit të fundit të qirasë financiare.

- Në rast se për të njëjtin mjet disponohen dy ose më shumë dokumente, si për shembull, deklaratë me referencë doganore DAV dhe faturë tatimore shitje, gjithmonë do të merret për t'u regjistruar në fushën "vlera e mjetit", vlera totale e mjetit që është më e madhe në këto dokumente.

- Vlera e mjetit në sistemin informatik të DPSHTRR-së do të plotësohet në monedhën lekë dhe në rast se vlera e mjetit nga dokumentacioni shoqërues është në monedhë tjetër, do të llogaritet vlera korresponduese në lekë, referuar kursit ditor të Bankës së Shqipërisë sipas datës së dokumentit në monedhë të huaj, printimi i së cilës pasi vulozet nga specialisti përkatës i bashkëlidhet dokumenteve.

d. Vlera e mjetit, për efekt të klasifikimit "Automjet luksoz", reduktohet (amortizohet) jo më shumë se 10% të vlerës së mbetur çdo vit, duke marrë si vlerë fillestare për efekt reduktimi (amortizimi) vlerën e fundit të regjistruar në sistem.

- Për mjetet që janë të regjistruara në sistemin e DPSHRR-së, të cilat shiten ose ndryshojnë pronësinë në një nga format e njohura nga Kodi Civil (kontratë shitblerjeje, kalim kapitali, dhurimi, dëshmi trashëgimie, faturë tatimore shitje etj.), vlera e mjetit për efekt klasifikimi si "Automjet luksoz", duke filluar nga 15 janari i vitit 2020 e në vazhdim, nuk mund të jetë më e vogël se vlera e mbetur e reduktuar (amortizuar) në fushën "vlera e mjetit" në sistem nga pronësia e fundit e tij, por është vlera më e madhe ndërmjet vlerës në dokumentin e fitimit të pronësisë dhe vlerës së mbetur të reduktuar (amortizuar).

- Për çdo vit të plotë reduktimi (amortizimi) i vlerës së mjetit është 10% e vlerës së mbetur. Për vitin kur mjeti regjistrohet për herë të parë, ndryshon pronësinë, çregjistrohet etj., reduktimi (amortizimi) i vlerës së mjetit do të jetë në raport me muajt e plotë pa përfshirë muajin e regjistrimit, muajin e ndryshimit të pronësisë ose muajin çregjistrimit në sistemin e DPSHTRR-së (vlera e mjetit e reduktuar (amortizuar) në fushën "vlera e mjetit" X 10% / 12 muaj X muajt e plotë pa përfshirë muajin e ndryshimit të pronësisë).

- Për mjetet të cilat janë debitoare për pagesën e taksës së përvitshme për automjetet luksoze për vitet 2016–2019, detyrimet do të llogariten dhe arkëtohen në bazë të vlerës që mjeti kishte në sistemin informatik të DPSHTRR-së ose në dokumentin e fitimit të pronësisë që ndodhet në dosjen e mjetit.”.

4. Në pikën 2.11.2, paragrafi i parë, ndryshon në përmbajtje si më poshtë:

“Taksa e përvitshme për automjetet luksoze është taksë vjetore për çdo vit kalendarik nga 1 janari deri më 31 dhjetor të vitit përkatës për të cilën llogaritet dhe paguhet dhe ka vlefshmëri 365 ditë, pavarësisht nga momenti në të cilën ajo paguhet. Detyrimi për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit. Kjo taksë paguhet në të njëjtin moment kur paguhet taksa vjetore e mjeteve të përdorura të transportit. E ardhura nga kjo taksë, për çdo rast, mbledhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, drejtoritë rajonale, në momentin e vjeljes së taksës vjetore të mjeteve të përdorura. Pronari i mjetit, i cili nuk kryen pagesën e kësaj takse brenda 10 ditëve nga mbarimi i afatit të vlefshmërisë së parashikuar, detyrohet të paguajë gjobë për shumën e detyrimit të papaguar për çdo ditë vonesë nga dita e fundit e vlefshmërisë. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike. PAGESA E KËSAJ TAKSE SHOQËROHET ME FATURËN E TAKSËS VJETORE TË MJETEVE TË PËRDORURA (TVMP)-SË”. Drejtoritë rajonale të shërbimeve të

transportit rrugor bëjnë regjistrimin ditor të arkëtimit të taksës, që shërben si dokument bazë për rakordimin e pagesës së taksës me organet e tatimeve. Regjistrimi bëhet në një regjistër të veçantë ose në mënyrë elektronike. DPSHTRR-ja, si agjent për llogaritjen dhe arkëtimin e taksës së regjistrimit fillestar dhe taksës së përvitshme për automjetet luksoze, përfiton 5 (pesë) për qind të shumës së arkëtuar. DPSHTRR-ja nga shuma mujore e arkëtuar nga taksa e regjistrimit fillestar (TRML) dhe taksa e përvitshme për automjetet luksoze (TVML), pasi mban komisionin prej 5 (pesë) % të totalit mujor të arkëtimeve nga TRML-ja dhe TVML-ja, pjesën tjetër të mbetur prej 95 (nëntëdhjetë e pesë) % e derdh për llogari të drejtorisë rajonale tatimore ku është i regjistruar (Drejtoria Rajonale Tatimore Njësia e Tatimpaguesve të Mëdhenj) brenda datës 15 të muajit pasardhës. Rakordimi i pagesës së TRML-së dhe TVML-së ndërmjet strukturave të DPSHTRR-së me organet tatimore të qeverisjes qendrore bëhet në bazë të regjistrimit ditor të taksës së regjistrimit fillestar dhe taksës së përvitshme për automjetet luksoze.”.

Shembull:

Mjeti me targë AAxxxAA është regjistruar ose ka bërë ndryshimin e pronësisë në sistemin me datë 30.1.2020 dhe vlera më e madhe e mjetit ndërmjet dokumentacionit financiar dhe vlerës së mbetur të reduktuar (amortizuar) në fushën “vlera e mjetit” është 5,800,000 lekë.

Më datën 10.4.2021 paraqitet për të bërë regjistrimin e ndryshimin e pronësisë së mjetit sipas kontratës së shitblerjes me vlerë 3,900,000 lekë. Vlera e mjetit e reduktuar (amortizuar) në raport me muajt e plotë të çdo viti, pa përfshirë muajin e ndryshimit të pronësisë më datë 10.4.2021 është 5,136,625 lekë.

Për efekt të klasifikimit si “Automjet luksoz” vlera më e madhe ndërmjet vlerës në dokumentin financiar të fitimit të pronësisë dhe vlerës së reduktuar në fushën “vlera e mjetit” do të merret parasysh vlera më e madhe që është 5,136,625 lekë.

Shembull:

Pronari i mjetit me targë AAxxxAA me cilindrata 3200 cc, me naftë, viti i prodhimit 2011, i regjistruar në sistemin informatik e DPSHTRR-së më 2.10.2014, i cili ka paguar detyrimet e TVMP-së dhe të TVML-së të vitit 2018, më 25.12.2018, me afat vlefshmërie deri më 25.12.2019, paraqitet për të bërë çregjistrimin e përhershëm të mjetit pranë zyrave të DPSHTRR-së, më datën 20.4.2020.

Përpara çregjistrimit të përhershëm të mjetit i llogariten dhe duhet të paguhen detyrimet e TVMP-së dhe të TVML-së dhe gjobën përkatëse për vitin 2019 dhe periudhën janar–prill 2020.

5. Pas pikës 2.11.2, shtohet pika 2.11.3, me këtë përmbajtje:

“2.11.3 Në zbatim të nenit 23, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, kur nga kontrolli i dosjes së mjetit konstatohet se vlera e mjetit, cilindrata, lloji i mjetit, lloji i karburantit, viti i prodhimit, numri i vendeve etj., nuk është e njëjtë me të dhënat e regjistruara në sistemin informatik e DPSHTRR-së, e për rrjedhojë lind një detyrim i ri për taksën, krahas masave për arkëtimin e këtyre detyrimeve, njoftimet, vendimet dhe komunikimet zyrtare të agjentit tatimor, drejtuar taksapaguesve, u dërgohen atyre në adresën e deklaruar nga vetë ato.

Këto njoftime i dërgohen taksapaguesit në rrugë elektronike, në rastin kur ai ka dhënë pëlqimin për pranimin e komunikimit në rrugë elektronike dhe është regjistruar si përdorues i shërbimit të sistemit të komunikimit elektronik, dhe nëpërmjet shërbimit postar në adresën e banimit të pronarit të mjetit sipas regjistrimit të gjendjes civile ose në adresës e selisë së tij deklaruar në QKB.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor në rolin e agjentit gjatë ushtrimit të funksionit të tij për mbledhjen e taksës, zbaton rregullat, parimet dhe procedurat e parashikuara në ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.”.

6. Shkronja “c”, e pikës 3.1, zëvendësohet me këtë përmbajtje:

“c. autoveturat tip deri në 4+1 vende dhe me cilindrata jo më shumë se 2500 kubikë, kur këto mjete kalojnë në zotërim të invalidëve e të veteranëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, invalidëve të punës, të verbërve, invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, personat

me aftësi të kufizuar që e fitojnë këtë status në bazë të ligjeve përkatëse dhe përdoren vetëm për nevojat e tyre personale dhe jo për veprimtari private.

Për veteranët e luftës për përjashtimin nga TVMP-ja, për çdo vit përjashtimi bëhet vetëm kur veprimet bëhen në emër të veteranit të luftës dhe duhet që:

i. Dosja e mjetit e qytetarit me status “veteran lufte” dhe dosja e invaliditetit e tij duhet të jenë nën juridiksionin territorial të drejtorisë rajonale ku ka vendbanimin qytetari me status “veteran lufte” sipas regjistrit të gjendjes civile.

ii. Të jetë i pajisur me “Librezën e veteranit”, në zbatim të ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Popullit Shqiptar”, i ndryshuar.

iii. Vërtetimin e siguar nga vetë qytetari me status “veteran lufte” nëpërmjet portalit e-albania, kjo në zbatim të VKM-së nr. 495, datë 13.9.2017 “Për miratimin e rregullave të përfitimit të shërbimeve publike elektronike”, që nuk zhvillon aktivitet privat.

iv. Kartën e identitetit të vlefshme të personit me status “veteran lufte” që ka në pronësi mjetin.

Për invalidët e punës, personat e verbër, të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, si dhe personat me aftësi të kufizuar, për përjashtimin nga TVMP-ja, për çdo vit përjashtimi bëhet vetëm kur veprimet bëhen në emër të qytetarit me status “invalid” dhe duhet që:

i. Dosja e mjetit e qytetarit me status “invalid” dhe dosja e invaliditetit e tij duhet të jenë nën juridiksionin territorial të drejtorisë rajonale ku ka vendbanimin qytetari me status “invalid” sipas regjistrit të gjendjes civile.

ii. Të jetë i pajisur me librezën e invaliditetit, lëshuar nga Shoqata e Invalidëve, në zbatim të nenit 4, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, i ndryshuar, ose librezën e verbërisë, ose librezën e paraplegjiku/tetraplegjiku lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, pasi verifikohet vlefshmëria e tyre fotokopjohet dhe mbahet nga strukturat e DPSHTRR-së.

iii. Vërtetim të KMCAP-it, i siguar nga vetë qytetari me status “invalid”, nëpërmjet portalit e-albania, kjo në zbatim të VKM-së nr. 495, datë 13.9.2017 “Për miratimin e rregullave të përfitimit të shërbimeve publike elektronike” ose vërtetimin origjinal të KMCAP-it ose i noterizuar, lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore për periudhën përkatëse të invaliditetit ose kopje e vendimin të Komisionit të Përcaktimit të Verbërisë lëshuar nga Komisioni Mjekësor i Përcaktimit të Verbërisë KMCAP-it për personat e verbër pasi verifikohet origjinali.

iv. Vërtetimin, e siguar nga vetë qytetari me status “invalid”, nëpërmjet portalit e-albania, në zbatim të VKM-së nr. 495, datë 13.9.2017 “Për miratimin e rregullave të përfitimit të shërbimeve publike elektronike”, që nuk zhvillon aktivitet privat.

v. Kartën e identitetit të vlefshme të personit me status “invalid” që ka në pronësi mjetin.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj